



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

KORNIZA E VLERËSIMIT NË ARSIMIN
PARASHKOLLOR



Tiranë

Tetor, 2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 9298/2 Prot.

Tiranë, më 06.11, 2019

URDHËR

Nr. 534, datë 06.11.2019

PËR

MIRATIMIN E KORNIZËS SË VLERËSIMIT
NË ARSIMIN PARASHKOLLOR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të neneve 25 dhe 26 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e kornizës së vlerësimit në arsimin parashkollor, bashkëlidhur.
2. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

BESA SHAHINI



Tabela e përmbajtjes

Tabela e përmbajtjes	2
Hyrje	3
Parimet themelore	4
Vlefshmëria dhe konfidencialiteti	4
Transparenca në vlerësim.....	4
Paanshmëria në vlerësim.....	5
Kriteri arsimor në vlerësim	5
Vlerësim tërësor i fëmijës	5
Përse duhet të vlerësojmë?	6
Përse duhet të përfshihen prindërit në procesin e vlerësimit?	7
Si të vlerësojmë?	8
Kur vlerëson mësuesi?	8
Llojet e vlerësimit	10
Vlerësimi diagnostikues	10
Vlerësimi formues	10
Vlerësimi autentik	11
Vlerësimi në qendrat e të nxënitorit.....	11
Vëzhgimi	12
Përdorimi i të dhënave si bazë për mësimdhënien	15
Mjete dhe strategji vlerësimi.....	17
Vëzhgimi dhe shënimet që mbahen gjatë tij	17
Fotografimi dhe shpjegimet për fotografitë e kryera	18
Listat e kontrollit	19
Treguesit e standardeve sipas fushave të zhvillimit dhe të nxënitorit	20
Historitë e të nxënitorit	21
Dosja e fëmijës	22
Fjalorth termash	24
Referenca	26



HYRJE

Korniza e vlerësimit në arsimin parashkollor është hartuar në kuadër të reformës kurrikulare të ndërmarrë në gjithë sistemin arsimor parauniversitar. Ky dokument është pjesë e paketës së dokumenteve të rëndësishme të miratuara nga MASR-ja, si: “Korniza Kurrikulare e arsimit parashkollor”, “Standardet e zhvillimit dhe të nxënies të fëmijëve 3-6 vjeç”, “Programet e parashkollorit për grup-moshat 3-4, 4-5 dhe 5-6 vjeç”, “Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor”.

Për hartimin e Kornizës së vlerësimit në arsimin parashkollor ka punuar një grup i madh specialistësh të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), specialistë pranë zyrave të arsimit, pedagogë dhe njohës të mirë të fushës së fëmijërisë së hershme etj. Grupi i punës u udhëhoq nga z. Gerti Janaqi, Drejtor i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar dhe znj. Aurela Zisi specialiste e kurrikulës pranë kësaj Agjencie. Në hartimin e këtij dokumenti kanë kontribuar znj. Shqiponja Lamçe, znj. Lindita Lutaj, znj. Edlira Sina, z. Esion Zgjana, znj. Majlinda Xhamo, znj. Leonora Rrokaj, znj. Liljana Cani, znj. Ermira Kurti, znj. Ermelinda Gjocaj, znj. Eniana Veli, znj. Majlinda Uca, znj. Mirela Kondili, znj. Elda Rika, znj. Aurora Tosku, znj. Flutura Muça, znj. Ardiana Gurra, znj. Donika Dervishi, znj. Katerina Grabova, znj. Miranda Kokona, znj. Anila Bozaxhiu, znj. Joana Cane, znj. Griselda Qosja, znj. Mimoza Përzhilla, znj. Elsa Dragjoshi.

Pas hartimit, Korniza e vlerësimit është konsultuar dhe diskutuar me një grup të gjerë mësuesish të arsimit parashkollor, kontributi i të cilëve është pasqyruar në këtë dokument.

Korniza e vlerësimit u hartua nën kujdesin e znj. Mirlinda Bushati, drejtuese e programit të Edukimit dhe Fëmijërisë së hershme në UNICEF Shqipëri. UNICEF-i mundësoi mbështetjen financiare dhe teknike si dhe konsulencën e ekspertës ndërkombëtare, Teresa Gonzales për hartimin e këtij dokumenti.

Hyrje

Korniza e vlerësimit¹ në arsimin parashkollor është hartuar për të mbështetur specialistët, mësuesit dhe stafin e kopshtit në vlerësimin e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve parashkollorë, të moshës 3-6-vjeçare. Kjo Kornizë përmban informacione e strategji kyç, për të cilat drejtuesit dhe mësuesit e arsimit parashkollor duhet të kenë njohuri gjatë zbatimit dhe monitorimit të programeve edukative që zbatohen në institucionet parashkollore.

Shqipëria ka shfaqur interes për të përvetësuar standardet e Bashkimit Evropian (BE). Në të gjitha vendet e BE-së ekzistojnë sisteme të caktuara për monitorimin e cilësisë së përkujdesjes dhe edukimit në fëmijërinë e hershme, duke përfshirë vlerësimet periodike të brendshme dhe të jashtme të kopshtit. Ndonëse qasjet e përdorura për monitorimin e cilësisë në programet e arsimit parashkollor janë të ndryshme, domosdoshmëria për të vendosur nevojat e fëmijëve në qendër të procesit konsiderohet thelbësore.

Praktikat e brendshme më të përdorura të vlerësimit formues në vendet e Bashkimit Evropian, marrin në konsideratë zhvillimin bazë të fëmijës, monitorojnë ecurinë e të nxënit të tyre dhe përvojat shoqëruese nëpërmjet vëzhgimit, dokumentimit, dosjes dhe raportimit me shkrim².

Studime të shumta nga shtetet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE) tregojnë se përdorimi i mënyrave jozyrtare të monitorimit, si vëzhgimi i vazhdueshëm dhe i drejtpërdrejtë dhe vlerësimi i kompetencave të fëmijëve, mund të ndikojnë pozitivisht në rezultatet e të nxënit të fëmijëve. Këto praktika bëjnë të mundur që mësuesit të arrijnë të kuptojnë më mirë procesin e të nxënit të fëmijëve në mjedisin e përditshëm të institucionit parashkollor³. Në fëmijërinë e hershme vlerësimi ka peshë të rëndësishme. Vlerësimi përdoret si mjet për të mbështetur të nxënë të fëmijëve. Gjithashtu, format e vlerësimit e ndihmojnë mësuesin të kuptojnë si një fëmijë është duke përparuar në një fushë të caktuar të nxëni ose në një fushë specifike zhvillimi. Nëpërmjet vlerësimit mund të identifikohen fëmijët që mund të jenë në rrezik ose mund të kenë nevojë për ndërhyrje të

¹ Ky dokument mbështetet në të gjitha studimet e kryera nga specialistët për fëmijërinë e hershme, si dhe në politikat dhe praktikatat e Bashkimit Evropian.

² Komisioni Evropian. Propozim i parimeve kyçe për një Kornizë cilësore për përkujdesjen dhe arsimin në fëmijërinë e hershme. Raporti i grupit të punës për përkujdesjen dhe arsimin në fëmijërinë e hershme me mbështetjen e Komisionit Evropian. Bashkimi Evropian. 2014, f. 53.

³ Komisioni Evropian, f. 54.



hershme dhe shërbime të arsimit të specializuar. Vlerësimi i fëmijës konsiderohet nxitje për më tej; është perceptim dhe dëshirë e fëmijës për t'u paraqitur në sytë e tjetrit, të nënës, të babait, vëllait, motrës, mësuesit etj.

Format e vlerësimit shërbejnë për mësuesin dhe prindin për të projektuar hapat e tjerë të të nxënit. Vlerësimi individual i fëmijës për qëllime të caktuara ka shumë rëndësi të dokumentohet. Vlerësimi bëhet për të mbledhur informacion *rreth* zhvillimit, të nxënit dhe përfitimit të fëmijëve nga kurrikula, metodat e mësimdhënies, mjedisi i të nxënit dhe e gjithë veprimtaria mësimore-edukative. Vlerësimi kryhet gjatë veprimtarive të përditshme në grup: kur fëmijët janë duke biseduar me fëmijët e tjerë ose me të rriturit, kur janë të përfshirë në lojëra dhe veprimtari individuale apo me të tjerë, kur janë duke bërë punime artistike ose duke ndërtuar me blloqe, kur janë duke ndenjtur vetë dhe duke u marrë me sendet vetjake, kur janë duke u marrë me veprimtari fizike, duke ngrënë ose duke pushuar.

Parimet themelore

Një vlerësim cilësor dhe i paanshëm bazohet në kritere të vlefshme, transparente dhe të zbatueshme. Ky vlerësim i shërben përmirësimit të të nxënit, atëherë kur procesi ka karakter edukativ dhe motivues dhe mbështetet në kritere, si:

Vlefshmëria dhe konfidencialiteti

Vlerësimi është konfidencial, që do kuptuar se vlerësimi i mësuesit ndahet me prindin dhe me stafin në mënyrë konfidenciale dhe për qëllime të identifikimit të standardeve të arritura gjatë zhvillimit ose për identifikim të barrierave të të nxënit që janë konstatuar tek fëmija. Vlerësimi duhet të sigurojë informacion të vlefshëm për idetë, proceset, rezultatet dhe vlerat që priten të krijohen te fëmijët gjatë procesit mësimor-edukativ.

Transparenca në vlerësim

Familja, prindërit gëzojnë të drejtën dhe kanë nevojë të njihen me kriteret dhe metodat me të cilat do të vlerësohen fëmijët. Kjo garanton sinkronizim të vlerësimit që vjen nga institucioni parashkollor me vlerësimin që vjen nga familja dhe prindërit.



Paanshmëria në vlerësim

Vlerësimi është i detyruar të përmbushet për çdo fëmijë përtej çdo lloj diskriminimi (përfshirë gjininë, etninë, gjuhën, racën, rrethanat ekonomike e shoqërore, vendndodhjen, si dhe personalitetin, talentin, aftësitë e kufizuara etj.).

Kriteri arsimor në vlerësim

Vlerësimi, në të gjitha rrethanat, kryhet me qëllim mbështetjen dhe ndihmën për fëmijën. Identifikimi i barrierave përgjatë të nxënit, konsiderohet vlerësim me qëllim të nxënit dhe nga kurrikula, konsiderohet detyrim procedural dhe profesional dhe kompetencë e mësuesit. Që të luajë këtë rol, vlerësimi duhet:

- Periodik;
- i dokumentuar;
- i qëllimshëm për rezultate të caktuara të nxëni;
- identifikues i pikave të forta, të dobëta gjatë të nxënit;
- të jetë stimulues, për rritje të vetërespektit dhe të kuptimit për veten;
- të kryhet nëpërmjet simbolikave të përshtatshme për moshën e fëmijëve.

Vlerësimi bëhet i vlefshëm kur është periodik, i dokumentuar, konfidencial dhe ndahet me prindërit.

Vlerësim tërësor i fëmijës

Vlerësimi tërësor bëhet në respekt dhe në përmbushje të fushave të nxënit, të rezultateve të pritshme, duke iu referuar fëmijës si individualitet i papërsëritshëm. Vlerësimi bëhet përtej çdo gjykimi, parapëlqimi dhe paragjykimi. Procesi i vlerësimit bëhet shumë i rëndësishëm, sidomos në moshën 5-6 vjeçare, për të vlerësuar gatishmërinë e fëmijës për t'u regjistruar në shkollë.

Ekziston një mirëkuptim midis studiuesve dhe politikëbërësve se, duke bërë lidhjen ndërmjet mbledhjes së të dhënave, kërkimeve dhe analizave sistematike, këto procese mund të jenë mjete të fuqishme për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve kurrikulare, në mbështetje të zhvillimit të fëmijëve.



Përse duhet të vlerësojmë?

Fëmijët që bëhen pjesë e sistemit arsimor, që në moshën 3-vjeçare, shfaqin një mori shprehish dhe aftësish. Sjelljet e tyre pasqyrojnë përvojat që kanë patur, që nga lindja e derisa kanë hyrë në kopsht, sasinë e fjalëve që kanë dëgjuar dhe përdorur, po ashtu dhe dëshirën e tyre për të mësuar.

Çdo fëmijë është unik, ka interesa vetjake, aftësi dhe përvoja të veçanta. Fëmijët kanë ndryshime në përmbushjen e treguesve të fushave të ndryshme të zhvillimit dhe ky ndryshim konsiderohet si një pjesë e natyrshme e aspekteve të zhvillimit njerëzor. Përvojat gjatë fëmijërisë së hershme i kanë ndihmuar fëmijët ta nxisin trurin të mësojë dhe të reagojë në mënyra të caktuara, të zhvillojnë disa fusha më shumë sesa të tjerat dhe të njohin disa fusha zhvillimore që nuk janë formësuar ende mirë. Është me rëndësi që mësuesit të kuptojnë çfarë e bën secilin fëmijë të veçantë dhe ta ndihmojë të ndjekë shtegun e vet të të nxënit.

Për të punuar në mënyrë të suksesshme me fëmijën, duhet të përcaktohet se në çfarë niveli vepron fëmija në lidhje me standardet e fushave të zhvillimit dhe të të nxënit. Dokumenti me titull “*Standardet e zhvillimit dhe të nxënit për fëmijët e moshës 3-6-vjeçare*” përshkruan fushat e zhvillimit, standardet për secilën prej tyre dhe treguesit sipas grupmoshave. Ato shërbejnë si udhëzues për mësuesit dhe prindërit dhe përcaktojnë kriteret e zhvillimit në fushat:

- Shëndeti, mirëqenia fizike dhe zhvillimi motorik
- Zhvillimi social dhe emocional
- Zhvillimit njohës dhe njohuritë e përgjithshme
- Zhvillimit gjuhësor, leximi dhe shkrimi
- Përqasja ndaj të nxënit

Teksa të vlerësuarit (njohja se si po ecën zhvillimi i fëmijës) në vitet e zhvillimit të hershëm konsiderohet si një proces i rëndësishëm, është e rëndësishme të përcaktohet se çfarë duhet të vlerësohet te një fëmijë. Mësuesit, prindërit dhe vetë fëmijët duhet të jenë të informuar se në çfarë shkalle ai/ajo po i përmbush treguesit e zhvillimit, bazuar në të kuptuarin tonë për zhvillimin aktual të fëmijës.

Të gjithë fëmijët, pavarësisht rrethanave, duhet të vlerësohen në lidhje me treguesit e standardeve të zhvillimit, për grupmoshën përkatëse. Në konsideratë duhet të merren edhe



faktorë pengues që ndikojnë në ecurinë individuale të fëmijës. Një fëmijë që ka luftuar me një sëmundje mund të duket më i vogël se moshatarët e vet; një fëmijë që ka kaluar një infeksion të rëndë në vesh, mund t'i shfaqen probleme të të dëgjuarit dhe si pasojë, ndoshta edhe në të folurit. Si pasojë, fëmija mund të ketë probleme/vështirësi për zhvillimin e hershëm të leximit dhe të shkrimit. Kryerja e vlerësimit në një mënyrë gjithëpërfshirëse do të pasqyrojë shumë nga këto sfida dhe do t'i mundësojë mësuesit/prindit që të kuptojë se ku nevojiten ndërhyrje individuale për ta ndihmuar përparimin e fëmijës.

Të nxënit tek fëmijët e vegjël ndodh në mënyrë aktive. Prandaj mësuesit mund t'i "vlerësojnë" fëmijët gjatë procesit të të nxënit. Vlerësimi i procesit duhet të jetë i planifikuar mirë, i shpeshtë dhe i mirorganizuar.

Përse duhet të përfshihen prindërit në procesin e vlerësimit?

Komunikimi i efektshëm me prindërit do ta forcojë procesin dhe cilësinë e vlerësimit në Shqipëri. Mësuesit nxiten që të komunikojnë me prindërit nëpërmjet një sërë veprimtarish që përfshijnë: dërgimin e dosjes në shtëpi, dërgimin e shënimeve të mbajtura gjatë veprimtarive të ndryshme, shpjegimeve rreth zhvillimit dhe bisedave ballë për ballë ndërmjet mësuesit dhe fëmijës në prani të anëtarëve të familjes.

Prindërit që përfshihen në edukimin e fëmijës forcojnë lidhjen midis familjes dhe kopshtit, sepse ndajnë me mësuesin pikat më të forta, interesat e fëmijës së tyre dhe njëkohësisht e mbështesin të nxënit e fëmijës në shtëpi. Studime të vazhdueshme tregojnë se përfshirja e familjes përmirëson rezultatet e të nxënit, ul numrin e mungesave dhe i nxit prindërit të kenë besim te kopshti që ndjek fëmija.

Ka vështirësi, pasi faktorë të ndryshëm mund ta pengojnë mundësinë e familjes për t'u lidhur me kopshtin; mundet që disa prindër të ndihen të përjashtuar dhe/ose të marrin pjesë në mënyrë pasive. Megjithatë, përfshirja e mundshme e familjes duhet të jetë një qëllim i të gjitha institucioneve parashkollore. Pjesëmarrja e familjes në procesin e të nxënit dhe ndjekja e ecurisë dhe e zhvillimit të fëmijës ndikon në përmirësimin e zhvillimit njohës, emocional, shoqëror, fizik dhe gjuhësor.



Si të vlerësojmë?

Fëmijët e shfaqin nivelin e tyre të të nxënit gjatë ditës, teksa flasin dhe dëgjojnë të tjerët dhe kur përfshihen në lojëra me të tjerë ose vetëm. Fëmijët mund të vëzhgohen teksa ndjekin udhëzime dhe reagojnë/ndryshojnë sjellje sipas situatave. Duke mbajtur menjëherë shënim vëzhgimet, mësuesi mund të gurmtojë të nxënit individual të fëmijëve. Nëse një mësues nuk është vëzhgues i mirë dhe nuk është i vetëdijshëm për ecurinë specifike të secilit fëmijë, programi mësimor nuk do t'i përmbushë nevojat e fëmijës.

Është e rëndësishme që ecuria e çdo fëmije të vlerësohet me mënyra konkrete, në mjedisin ku ndodhet fëmija. Fëmijët e vegjël, që bëhen për herë të parë pjesë e sistemit arsimor, i nënshtrohen një procesi përshtatjeje me këtë mjedis të ri dhe të ndryshëm nga mjedisi familjar. Atyre duhet t'u jepet kohë që të shfaqin aftësitë e tyre, duke u ofruar një sërë mundësish interesante të të nxënit.

Këto mundësi duhet të jenë të përshtatshme për fazën e tyre të zhvillimit dhe duhet t'u përmbahen aftësive të fëmijëve, pa përfshirë mbështetjen e jashtme (që do të thotë, në fazën e zhvillimit të tyre proksimal, sipas Vygotsky-t⁴). Kjo gjë u jep kohë fëmijëve të ndihen të mbrojtur dhe të sigurtë dhe, rrjedhimisht, të jenë të aftë të shfaqin më së miri atë çka dinë. Kjo periudhë do t'i japë mësuesit mundësinë për ta vëzhguar secilin fëmijë, të përcaktojë për çfarë ka njohuri fëmija dhe çfarë është i aftë të bëjë etj. Pra, të kuptojë bazat e tyre të të nxënit. Më tej, mësuesi planifikon veprimtari që ta çojë të nxënit e fëmijës në një shkallë më të lartë drejt suksesit.

Kur vlerëson mësuesi?

Të gjitha veprimtaritë ofrojnë mundësi për të vlerësuar. Jo gjithçka është e mundur të mbahet shënim, por informacioni i duhur për zhvillimin e fëmijës, për procesin e të nxënit dhe për mënyrat si vepron/reagon çdo fëmijë në situata të caktuara e të improvizuara, duhet siguruar nga mësuesi, me qëllim që për çdo fëmijë të krijohet panorama e plotë si po zhvillohet dhe si po ndryshon me kalimin e kohës.

⁴ Fromberg, Doris. *Play and Meaning in Early Childhood Education*. Boston, M. A.: Allyn and Bacon, 2002.



Është në dorën e mësuesit të mbledhë, të mbajë shënim apo të dokumentojë të nxënit e fëmijëve teksa marrin pjesë rregullisht në veprimtaritë që zhvillohen në klasë, përfshirë lojën dhe aktivitetet e tyre të lira.



Llojet e vlerësimit

Vlerësimi diagnostikues

Vlerësimi diagnostikues është një proces tërësor që përdoret për të trajtuar pyetjet në lidhje me zhvillimin, njohuritë dhe aftësitë e fëmijëve të vegjël. Vlerësimi duhet të udhëzojë ndërhyrjet e qëllimshme në mënyrë që të sigurohet që të gjithë fëmijët të kenë sukses gjatë fëmijërisë së tyre të hershme. Është e rëndësishme që mësuesit të përdorin rezultatet e vlerësimit diagnostikues për të planifikuar e përmirësuar mësimdhënien për gjithë vitin.

Në fillim të vitit shkollor (në muajt shtator-tetor), mësuesi duhet të marrë kohën e nevojshme për ta njohur secilin fëmijë. Këto konsiderohen si të dhëna-bazë, të cilat ofrojnë pikënisje për të nxënit, rrjedhimisht dhe për mësimdhënien. Në rastet kur fëmija hyn në kopsht pasi ka filluar viti i ri shkollor, mësuesi duhet ta bëjë vlerësimin e tij diagnostikues brenda dy muajve të parë pas regjistrimit në kopsht.

Shumë fëmijë shfaqin situata të tensionuara në ditët e para të fillimit të kopshtit, të krijimit të shoqërive të reja dhe të largimit nga familja. Disa mund të ndihen jo shumë të zotë për t'ia dalë mbanë e për ta ndjekur kopshtin. Vlerësimi në fillim të vitit shkollor duhet të jetë autentik dhe i përqendruar në atë që çdo fëmijë shfaq në rutinën e përditshme të klasës.

Në përgjithësi, vlerësimi duhet të mbulojë të gjitha fushat e zhvillimit:

- Sa po shoqërohen me fëmijët e tjerë?
- a po e rregullojnë dhe kontrollojnë sjelljen e tyre?
- Si po e përdorin gjuhën për të komunikuar me të tjerët?
- Sa i pasur është fjalori i tyre? A janë në gjendje t'i shqiptojnë drejt tingujt/fjalët?
- Sa të zhvilluara janë aftësitë e tyre të motorikës së madhe?
- Sa të zhvilluara janë aftësitë e tyre të motorikës së vogël?
- Si e kanë shfaqur zhvillimin e tyre njohës etj.?

Vlerësimi formues

Vlerësimi formues është procesi i mbledhjes së informacionit dhe mbështetja e të nxënit të fëmijëve bazuar në këtë informacion. Ndërsa fëmijët përparojnë me programin mësimor, ata



fillojnë të shfaqin shenja përmirësimi në shumë (ose në të gjitha) fushat e zhvillimit. Për të evidentuar ecurinë e secilit fëmijë, mësuesit përdorin metoda të vlerësimit formues për të mbështetur të nxënit e tyre dhe për të përcaktuar metodat e përshtatshme mësimore. Ky lloj vlerësimi ndodh gjatë procesit të mësimdhënies dhe të të nxënit. Ai identifikon *çfarë është nxënë*, çfarë duhet nxënë më pas dhe cilat hapa të mëtejshëm nevojiten për të mbështetur të nxënit e fëmijëve. Vlerësimi formues mund të përfshijë:

- vëzhgimin e fëmijëve të përfshirë në procesin e tyre të të nxënit;
- ndarjen e qëllimeve të të nxënit me fëmijët;
- përfshirjen e fëmijëve në vetëvlerësim;
- pyetje efektive për të përparuar me procesin e të menduarit dhe të të nxënit;
- dhënien e mendimeve që i ndihmojnë fëmijët të dallojnë hapat e mëtejshëm dhe se si t'i hedhin ato;
- përshtatjen e mësimdhënies për shkak të vlerësimit.

Vlerësimi autentik

Vlerësimi autentik i fëmijëve të vegjël në përgjithësi kryhet në formën e vëzhgimit. Ai ndodh kur mësuesi vëzhgon, në mënyrë të kujdesshme dhe sistematike, fëmijën që po merret me një veprimtari të rregullt që është kuptimplotë për të (fëmijën).

Vlerësimi autentik zakonisht ofron mendime më të sakta dhe pasqyruese të të nxënit të fëmijëve. Në veçanti, u përshtatet më mirë fëmijëve që kanë vështirësi në të nxënë. Përshtatjet bëhen më të lehta nëpërmjet lojës, për të lejuar nevojat e fëmijës, duke përfshirë përshkallëzimin e të nxënit. Mësuesi mund ta vlerësojë fëmijën brenda një përvoje të sigurt dhe edukuese të të nxënit. Vlerësimi autentik gjithashtu lejon vëzhgime të fushave të ndryshme të të nxënit në të njëjtën kohë.

Vlerësimi në qendrat e të nxënit

Qendrat e të nxënit njihen edhe si qendrat e veprimtarive. Qëllimi i tyre përcaktohet nga materialet që vendosen aty dhe mund të përshtaten për një sërë nevojash, aftësish dhe shprehish. Loja përcaktohet nga fëmijët dhe jo nga mësuesi dhe duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme, në mënyrë që fëmijët të mund t'i përdorin materialet siç duhet.



Qendrat e të nxënit u ofrojnë fëmijëve mundësinë për të zbatuar njohuritë e tyre në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe mundësinë të vëzhgojnë se si fëmijët e tjerë sillen në të njëjtën mënyrë. Ata mësojnë nga njëri-tjetri në shumë rrethana. Mësuesi mund të vëzhgojë fëmijët ndërkohë që ata shpalosin kuptimet, njohuritë dhe aftësitë e tyre, si dhe ndjenjat e tyre ndaj të nxënit, duke u mënjanuar dhe duke vështuar ose duke marrë përsipër një rol dhe duke u përfshirë në lojë/veprimtari me fëmijët e tjerë.

Teksa mësuesi i vendos materialet e të nxënit në qendrat përkatëse, fëmijët kanë mundësi të ndërveprojnë me një sërë materialesh dhe të zbulojnë fusha të reja të të menduarit. Materialet i orientojnë fëmijët se çfarë do të ndodhë gjatë lojës. Pasuria dhe shumëllojshmëria e materialeve do t'i nxisin fëmijët ta çojnë procesin e tyre të të nxënit në një nivel tjetër, duke pasuruar fjalorin, duke menduar në mënyra të tjera, duke vëzhguar se si fëmijët e tjerë veprojnë në të njëjtën situatë dhe duke i përmirësuar sjelljet vetjake teksa ndërveprojnë me të tjerët.

Në mjediset e sigurta e të njohura për ta, fëmijët kanë më shumë gjasa t'i shfaqin ato që dinë dhe kuptojnë se duhet t'i përdorin këto aftësi kur përfshihen në një detyrë të re. Planifikimi kërkon që mësuesi:

- të përcaktojë fushën dhe standardet që do të vlerësojë;
- të identifikojë treguesit përkatës të standardeve;
- të organizojë veprimtaritë/mundësitë e përshtatshme të të nxënit, që lidhen me këta tregues;
- të përcaktojë mënyrën për mbajtjen shënim të informacionit dhe
- të vendosë objektiva të përgjithshëm dhe të veçantë.

Vëzhgimi

Vëzhgimi është një mjet vlerësimi i dobishëm dhe i fuqishëm për fëmijët parashkollorë. Vëzhgimi i fëmijëve e ndihmon mësuesin:

- të mbledhë informacionin, që mund të përdoret në mënyrë më specifike për mësimdhënie;
- të vendosë cilat burime do të duhen për të zgjeruar apo për të përforcuar më tej të nxënit;
- të identifikojë nëse janë përmbushur qëllimet e programit;



- të komunikojë me prindërit dhe fëmijët.⁵

Autorët e librit të dobishëm *The Power of Observation for Birth Through Eight* (Fuqia e vëzhgimit nga lindja deri në tetë vjeç), theksojnë rëndësinë e përdorimit të vëzhgimeve për të krijuar marrëdhëniet me fëmijët. Ata shprehen se:

kur vëzhgojmë, ne ngadalësojmë, dëgjojmë më me vëmendje dhe ndalemi për të menduar përpara se të ndërhyjmë, duke ofruar drejtime apo ndihmë. Vëzhgimi ndihmon të krijojmë marrëdhënie përmes zbulimit të veçantisë së secilit fëmijë—përfshirë temperamentin, pikat e forta, personalitetin, stilin e punës dhe mënyrën e parapëlqyer të shprehjes së fëmijës.⁶

Kur fëmijët krijojnë një marrëdhënie pozitive me mësuesin, ata vendosin themelin e përvojave pozitive të të nxënit. Ata forcojnë besimin e fëmijëve që, kur t'u kërkohet të provojnë diçka të re, detyra do të jetë e arritshme, mbështetja do të ofrohet në mënyrë pozitive dhe të përshtatshme dhe mësuesi do t'i respektojë mendimet dhe përgjigjet e fëmijëve. Këto marrëdhënie pozitive i ndihmojnë fëmijët që të ndërtojnë pikat e tyre të forta emocionale, ndërkohë që angazhohen në marrëdhënie pozitive e reciproke. Kjo ndikon tërësisht te jeta e fëmijës, pasi truri krijon shtigje që e lejojnë fëmijën të jetë i hapur ndaj procesit të të nxënit dhe marrëdhënieve, në vend që të jetë i mbyllur. Kur mësuesi ulet me fëmijën dhe i drejton ata gjatë të nxënit, duke vëzhguar se çfarë shtytje e vogël mbështetjeje mund ta përmirësojë të nxënit, ai mund të ketë pritshmëri të larta dhe të përparojë të nxënit e fëmijëve.

Në përgjithësi, mësuesit dinë shumë për fëmijët e grupit në të cilin punojnë. Ata mund të identifikojnë se cilët fëmijë kanë ecuri të mirë, si dhe ata që kanë vështirësi. Ata mund të dinë detaje të jetës familjare të fëmijëve apo interesat e tyre. Gjithë ky informacion e ndihmon mësuesin që të planifikojë veprimtaritë e përshtatshme për fëmijët. Mësuesit mund të planifikojnë një proces të nxëni më të përparuar, duke dokumentuar të nxënit, duke krijuar marrëdhënie kuptimplota me fëmijët dhe duke marrë vendime bazuar në këtë informacion.

5. Vaclavik, Marion, Wolanski, Aimee, dhe Wannamaker, Nancy. *Observation: A Focus on Evaluation, Planning and Growth for the Kindergarten Learner*. Toronto, ON: Elementary Teachers' Federation of Ontario. 2001. f. 7-8

6. Jablon, Judy R., Dombro, Amy Laura, dhe Dichtelmiller, Margo L. *The Power of Observation for Birth Through Eight*. Washington, D.C.: National Association for the Education of Young Children. 2007. f. 11



Jablon, Dombro dhe Dichtelmiller sugjerojnë se një mësues, që dëshiron të bëhet një vëzhgues i zoti duhet të pyesë:

- Çfarë dua të mësoj?
- Kur dhe ku duhet të vëzhgoj për të marrë informacionin që dua?
- Si ta mbaj shënim atë që vëzhgoj?
- Si do ta organizoj informacionin që po mbledh?⁷

Mësuesit duhet ta pyesin veten rregullisht nëse kanë:

- *informacion më shumë në një të fushë zhvillimi se sa në të tjerat?*
- *informacion më shumë për disa fëmijë dhe jo mjaftueshëm për disa të tjerë?*
- *vëzhgime dhe të dhëna nga të gjitha fushat e zhvillimit?*
- *një plan për të trajtuar mospërputhjet?*

Çfarë dua të mësoj?

Ndërkohë që lexon vëzhgimet e bëra gjatë ditës, mësuesi mund të ngrejë pyetje, të cilat kërkojnë reflektime dhe studime të rasteve apo të sjelljeve të ngjashme.

Kur dhe ku duhet të vëzhgoj për të marrë informacionin që dua?

Mësuesi duhet të marrë parasysh mundësitë e pranishme në klasë dhe të planifikojë mundësitë e të nxënit dhe të vlerësimit përkatës për ata fëmijë, për të cilët është i shqetësuar.

Si ta mbaj shënim atë që vëzhgoj?

Ka shumë mënyra për të mbajtur shënim informacionin e mbledhur. Më e rëndësishmja është që të gjendet metoda më e përshtatshme për secilin mësues. Disa mësues mund të duan të ruajnë të dhëna në kompjuter, ku mund t'i shënojnë në fund të ditës dhe të tjerë mund të duan fletë të bardha në një dosje me mekanizëm, që t'i arrijnë lehtë gjatë mbajtjes së shënimeve për secilin fëmijë, duke përdorur një sistem kodi me ngjyra për fushat e zhvillimit. Çdo mësues ka stilin e vet të mbajtjes së shënimeve dhe duhet të gjejë çfarë funksionon më mirë për ta.

7. Jablon, Judy R., Dombro, Amy Laura, dhe Dichtelmiller, Margo L. 2007. f. 168



*Si do ta organizoj informacionin që mbledh?*⁸

Është më e lehtë po të jesh i qëndrueshëm me metodat e mbledhjes së informacionit. Të dhënat e vlerësimit janë të dobishme vetëm kur shërbejnë si bazë për mësimdhënien.

Mësuesi duhet të reflektojë mbi informacionin e mbledhur dhe të vendosë se çfarë të prezantojë apo të mësojë më pas. Kjo shpesh ndodh në çast, kur mësuesi vendos se cilat nga gjërat që ka parë dhe dëgjuar duhet të mbahet shënim.

Mësuesi duhet të rishikojë shënimet dhe të dhënat në mënyrë të rregullt, ndonjëherë duke parë për shembuj specifikë dhe herë të tjera duke parë të dhënat në mënyrë të përgjithshme për të dalluar prirjet. Kjo u kujton mësuesve që mësimet dhe veprimtaritë nuk përgatiten shumë herët në kohë ose të merren direkt nga një libër. Ato planifikohen duke pasur në mendje fëmijët, në mënyrë që ata të ndjekin rrugë të ndryshme gjatë procesit të tyre të të nxënit. I njëjti informacion do të përdoret për t'iu raportuar prindërve ose për të shkruar raportet e fëmijëve. Këto vëzhgime janë themeli i punës dhe i vlerësimit në arsimin parashkollor.

Përdorimi i të dhënave si bazë për mësimdhënien


Kur mësuesi fillon të mbledhë dhe të mbajë shënim të dhënat e vlerësimit, ai duhet të pyesë veten se çfarë tregojnë të dhënat dhe si t'i përdorë ato për planifikim për individët dhe grupet.

Një metodë e thjeshtë për përdorimin e të dhënave është formimi i përkohshëm dhe i rregullt i grupeve specifike, me nevoja të ngjashme. Kjo e ndihmon mësuesin të identifikojë fëmijët që kanë nevojë për përmirësim. Përveç sjelljeve që vëzhgojnë, mësuesit duhet të mbajnë shënim edhe mendimet e veta.

Dokumentimi duhet të jetë pjesë e qëndrueshme e vlerësimit, e planifikimit dhe e procesit të të nxënit. Mësuesit duhet të marrin parasysh të dhënat që kanë mbledhur dhe t'i krahasojnë ato me sjelljet e fëmijëve me kalimin e kohës dhe me standardet. Ata duhet të marrin parasysh edhe nevojat specifike të të nxënit të fëmijëve të identifikuar dhe i përshtasin pritshmëritë dhe/ose strategjitë e mësimdhënies, sipas rastit. Vlerësimi ndodh sipas një cikli:

⁸ Jablon, Judy R., Dombro, Amy Laura, dhe Dichtelmiller, Margo L. The Power of Observation for Birth Through Eight. Washington, D.C.: National Association for the Education of Young Children. 2007. f. 168





Vlerësimi është cikël i vazhdueshëm i rritjes. Mësuesi:

1. vlerëson duke mbledhur informacionin që tregon atë që dinë fëmijët;
2. reflekton në lidhje me informacionin. *Cilat njohuri apo aftësi mungojnë dhe duhet të trajtohen? Çfarë planesh duhet të hartohen që të ndërmerren hapat e duhur në vijim?*
3. përshtat planet. Ofrohen mundësi specifike të nxëni, në mënyrë që të përmbushen nevojat e fëmijëve.
4. zbaton planin. Vendosen materiale të ndryshme në qendrat mësimore. Punohet me grupe të caktuara fëmijësh që kanë nevojë për mbështetje. Ofrohen mundësi të reja për fëmijët që janë gati.
5. bën rivlerësime mbi bazën e të dhënave të përditësuara.

Ndërkohë që vlerësimi për të nxënë, si proces, përfshin mbledhjen e të dhënave me anë të metodave të ndryshme, vlerësimi i të nxënit është gjykimi ose interpretimi i të dhënave. Ky dallim mund të jetë i nevojshëm t'u jepet prindërve, por, në përgjithësi, vlerësimi ose analizimi i informacionit të mbledhur rregullisht është thelbësor për të dokumentuar dhe përshpejtuar të nxënit e fëmijëve në programin parashkollor.

Meqë këto vite janë kritike, kur fëmijëve duhet t'u jepen mundësi të zhvillohen në tërësi, është e rëndësishme që edhe ecuria e fëmijëve të raportohet në tërësi.



Mjete dhe strategji vlerësimi

Vëzhgimi dhe shënimet që mbahen gjatë tij

Përshkrimi	Shënimet dokumentojnë vëzhgimet. Vëzhgimet duhet të mbahen shënim sapo ndodh sjellja. Ato përshkruajnë një ndodhi dhe përfshijnë emrin, datën, kontekstin dhe vendndodhjen. Mund të jenë aq të hollësishme sa të jetë e nevojshme dhe më shumë të përshkruajnë sesa të gjykojnë atë që ka ndodhur . Zakonisht, informacioni përqendrohet te një fëmijë, por mund të përfshijë dhe të tjerë, nëse është e përshtatshme.
Për kë do të përdoren?	Shënimet e vëzhgimit duhet të mbahen për çdo fëmijë .
Kur do të përdoret?	Vëzhgimet për fëmijët fillojnë që ditën e parë, për të treguar zhvillimin dhe përmirësimin me kalimin e kohës. Nuk pretendohet të jenë vlerësuese, prandaj realizohen gjatë rutinës së përditshme të kopshtit. Vëzhgimet duhet të përdoren gjatë gjithë vitit .
Përse do të përdoren?	Këto shënime do të shërbejnë si një seri panoramash me kalimin e kohës , ndërkohë që fëmijët mësojnë aftësi të reja dhe përshtaten me mjedisin e kopshtit. Ato rikujtojnë shumë mirë ecurinë gjatë vitit.
Si do të përdoren?	Shënimet e vëzhgimit tregojnë historinë, por mësuesi duhet t'i analizojë dhe të vërë re prirje, shqetësime ose mundësi të reja të nxëni që duhen planifikuar.



Fotografimi dhe shpjegimet për fotografitë e kryera

Përshkrimi	Fotografohet një fëmijë i përfshirë në një veprimtari, duke u siguruar që fotografia e identifikon të nxënit. Ngjitet fotografia në karton dhe përshkruhet veprimtaria me hollësi.
Me kë do të përdoret?	Me të gjithë fëmijët, me përjashtim të rastit kur prindi nuk firmos formularin e marrjes së pëlqimit për përdorimin e fotografisë.
Kur do të përdoren?	Fotografitë realizohen çdo muaj. Kjo formë e dokumentimit të vlerësimit tregon përmirësimin me kalimin e kohës për veprimtari, si loja me blloqe ndërtuese, projektet në grup etj., në mënyrë efektive. Fotografitë përdoren gjatë gjithë vitit.
Përse do të përdoret?	Për ato veprimtari që janë shumë të vështira për t'u dokumentuar, fotografia ndihmon për të bërë analizim të mëvonshëm ose vetëvlerësim.
Si do të përdoren?	Fotografitë mund të ndihmojnë në informimin e prindërve për mënyrën se si kryhet vlerësimi gjatë lojës. Te fotografitë shtohen komentet e vëzhgimit që bën fëmija ndërkohë që sheh fotografitë dhe flet për gjërat që po bënte apo po mendonte. Fotografitë tregojnë histori/ çaste të caktuara për të nxënit e një ose dy fëmijëve.



Listat e kontrollit

Përshkrimi	Listat e kontrollit shërbejnë për të dokumentuar sjellje të identifikueshme.
Me kë do të përdoren?	Listat e kontrollit mund të përdoren për fëmijë të caktuar, por vlejné edhe për grupe ose të gjithë klasën.
Kur do të përdoren?	Listat e kontrollit mund të përdoren sa herë që veprimtaria vëzhgohet me lehtësi dhe është specifike. Nuk duhet të ketë lidhje me zhvillimin emocional.
Përse do të përdoren?	Listat e kontrollit mund ta ndihmojnë mësuesin t'i ndajë fëmijët në grupe, për mësimdhënie specifike në mënyrë të përkohshme. Grupet i identifikojnë nevojat aktuale, që mund të ndryshojnë, ndërkohë që fëmijët përparojnë në të nxënë.
Si do të përdoren?	Mësuesit krijojnë/përshtasin lista kontrolli, duke i organizuar të dhënat dhe duke krijuar grupe të përkohshme fëmijësh me nevoja të ngjashme.



Treguesit e standardeve sipas fushave të zhvillimit dhe të nxënit

Përshkrimi	Standardet ndahen në 5 fusha të zhvillimit të fëmijës . Për secilën grupmoshë janë përcaktuar treguesit të lidhur me njohurinë, aftësitë apo sjelljen specifike.
Me kë do të përdoren?	Me të gjithë fëmijët
Kur do të përdoren?	Në fillim të vitit, vlerësohen të dhënat bazë sipas treguesve të standardeve, të cilave u referohen gjatë gjithë vitit , për t'u siguruar që fëmijët po përparojnë, sidomos ata që e kanë të vështirë t'i përmbushin ato.
Përse do të përdoren?	Standardet ofrojnë një kornizë të përgjithshme reference, kundrejt të cilave mund të vlerësohen fëmijët. Të gjithë fëmijët vlerësohen sipas kriterëve të njëjta (treguesit), por në pika të ndryshme përgjatë procesit.
Si do të përdoren?	Standardet duhet të përdoren për vendosjen e kriterëve për ecurinë e të nxënit. Kriteret janë të përbashkëta për të gjithë fëmijët, por mënyrat se si mësuesi ndihmon ecurinë e fëmijëve, janë individuale.



Historitë e të nxënit

Përshkrimi	Historitë e të nxënit janë rrëfime me shkrim, që shërbejnë për të treguar histori në lidhje me mënyrën si kanë ndërvepruar fëmijët me të rriturit ose me fëmijët e tjerë për të shfaqur të kuptuarit dhe të nxënit e tyre.
Me kë do të përdoren?	Historitë e të nxënit janë të efektshme kur fëmijët punojnë në grup ose me një të rritur për të zgjidhur një problem ose për të krijuar një rrjedhë të nxëni. Të gjithë fëmijët duhet të dokumentohen në periudha të ndryshme gjatë vitit.
Kur do të përdoren?	Historitë e të nxënit mund të përdoren gjatë gjithë vitit në momente të ndryshme të veprimtarive ditore.
Përse do të përdoren?	Historitë shërbejnë për të ndjekur ecurinë e fëmijës me kalimin e kohës dhe për ta raportuar atë. Kjo metodë e lejon mësuesin të kuptojë se cilat ndërhyrje kanë prirjen për të qenë më të efektshme dhe me cilët fëmijë.
Si do të përdoren?	Historitë e të nxënit vendosen në dosjen e çdo fëmije , për reflektim të mëtejshëm me prindërit dhe fëmijët.



Dosja e fëmijës

Dosja është një përmbledhje e punimeve përfaqësuese të fëmijës, si mënyrë gjithëpërfshirëse për të parë interesat e tij, çfarë po nxë, si po i zbaton njohuritë e reja dhe aftësitë e përftuara dhe si e shpreh veten.

Fëmijët parashkollorë janë shumë të vegjël, ndaj dosjet e tyre duhet të jenë të përshtatura për moshën që kanë. Dalëngadalë fëmijët fillojnë të kuptojnë se dosja është një vend ku ruhen punime, të cilat tregojnë çfarë kanë nxënë gjatë vitit. Në këtë mënyrë, fëmijët kanë mundësi të kontribuojnë me punime që mendojnë se përfaqësojnë rritjen e tyre të të nxënimit si dhe interesat që kanë.

Në mënyrë që të tregohet rritja e herëpashershme, të gjitha punimet përfaqësuese duhet të kenë datën dhe llojet e ngjashme të punimeve duhet të mblidhen dhe të krahasohen. Mësuesit bashkë me fëmijët duhet të shikojnë punimet dhe të bëjnë krahasimet. Krahasimi duhet të përqendrohet gjithnjë te rritja dhe nxënia e fëmijës dhe jo të krahasohet me fëmijët e tjerë. Gjithsesi, mësuesit mund të përdorin punimet për të krahasuar fëmijët me atë çka është tipike për moshën, në mënyrë që të planifikojnë hapat e tjerë të të nxënimit. Ky proces është gjithashtu i dobishëm për të diskutuar ecurinë e fëmijës me prindërit. Prindërve mund t'u tregohet ecuria dhe të nxënimit apo që fëmija po has në vështirësi dhe ka nevojë për ndihmë shtesë. Ai qartëson nivelet e aftësive që zotëron fëmija.

Përshkrimi	Dosja mbushet me punime të përzgjedhura, përfaqësuese të fëmijëve. Përdorimi i punës origjinale do ndihmojë vetë fëmijën, mësuesin dhe prindin të shohin ecurinë e tij në çdo kohë. Të gjitha materialet duhet të përzgjidhen nga mësuesit, por me raste edhe nga fëmija.
Me kë do të përdoret?	Të gjithë fëmijët mund t'i fusin punimet përfaqësuese në dosje dhe pyeten të reflektojnë për atë se çfarë kanë mësuar për veten e tyre si nxënës.
Kur do të përdoret?	Dosjet duhet të përdoren përgjatë gjithë vitit shkollor , pasi fëmijët përfshihen në <i>detyra</i> më të vështira dhe mësojnë të flasin për mënyrën e tyre të të menduarit.



Përse do të përdoret?

Dosja është një mënyrë për të organizuar punimet përfaqësuese me kalimin e kohës, për të treguar rritjen e fëmijëve. Mësuesi mund t'i diskutojë punimet me fëmijët dhe të përshkallëzojë bisedën duke dhënë shembuj pozitivë dhe duke dhënë sugjerime për rritjen e tyre. Kjo është një **mënyrë shumë e efektshme për t'u mësuar fëmijëve të vegjël vetëreflektimin, në mënyrë që ata të kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë për t'u përmirësuar në të ardhmen.**

Si do të përdoret?

Dosjet duhet të përmbajnë shembuj të punës së pavarur të fëmijëve. Në këtë mënyrë, punimet përfaqësuese janë **shembuj autentikë të asaj çka fëmijët mund të bëjnë dhe asaj se çfarë dinë.** Më pas, mësuesit i përdorin këto punime për të përcaktuar nëse fëmijët po i përmbushin standardet e të nxënit.



Fjalorth termash

Termi	Përkufizimi
Vlerësimi autentik	Një vlerësim që ndodh kur mësuesit vëzhgojnë me kujdes dhe në mënyrë sistematike fëmijët tek marrin pjesë në veprimtaritë e përditshme. Vlerësimi autentik prek thelbin e nxënies dhe zhvillimit të fëmijëve.
Kompetencë	Kompetencat janë ndërthurje sjelljesh, aftësish dhe njohurish që fëmijët zhvillojnë dhe aplikojnë për një nxënie, jetë dhe punësim të ardhshëm të suksesshëm. Kompetencat gjatë nxënies së hershme duhet të shihen si gjithëpërfshirëse dhe që zhvillohen në marrëdhënie të ndërsjella mes fëmijëve, mësuesve, prindërve dhe komunitetit.
Vlerësimi diagnostikues	Një vlerësim që përdoret për të identifikuar gatishmërinë, njohuritë dhe aftësitë e fëmijëve. Shërben si bazë të dhënash për fëmijët kur hyjnë për herë të parë në kopsht ose në fillimin e vitit të ri shkollor. Ndhmon mësuesit të planifikojnë për gjithë periudhën.
Mësimdhënie e diferencuar	Mësimdhënia e diferencuar përshtat mësimdhënien me nevojat individuale të fëmijëve. Kjo lloj qasjeje mbështet ndryshimet individuale duke marrë parasysh stilet e mësimnxënies dhe aftësitë e fëmijëve.
Vlerësimi formues (Vlerësim për të nxënë)	Një pjesë përbërëse e mësimdhënies, e të nxënit dhe e vlerësimit, do të thotë që mësuesit gjykojnë dhe vendosin duke interpretuar të dhënat e mbledhura. Vlerësimi formues vlerëson rregullisht çka është nxënë, çka duhet nxënë dhe cilat janë hapat e mëtejshëm që nevojiten për të ndihmuar të nxënit e fëmijëve. Fokusi kryesor i vlerësimit formues është identifikimi i fushave të rishikimit të kurrikulës për t'i ndihmuar fëmijët të përmirësohen.
Qendrat e veprimtarive	Qendrat e të nxënit (veprimtarive) janë të zakonshme në një mjedis të klasës parashkolllore. Ato janë krijuar që të përqendrohen te zhvillimi tërësor i fëmijës duke përdorur lojën si një mjet të nxëni.



	Fëmijët duhet të zhvendosen ndërmjet këtyre qendrave kur t'i udhëzojnë mësuesit. Koha që shpenzohet në qendrat e të nxënit mund të zgjasë nga 25 në 80 minuta.
Loja	Loja është një mjet që ndihmon të nxënit e gëzueshëm dhe konceptues të fëmijëve në mënyra të pasura dhe të larmishme. Studimet tregojnë se ka një lidhje mes lojës dhe kapaciteteve themelore si vetëpërmbytja, aftësitë gjuhësore orale, aftësitë shoqërore dhe zhvillimi fizik. Loja nuk e zbeh të nxënit akademik, në të kundërt, ajo mbështet suksesin në kopsht.
Rubrikat	Një mënyrë për të krijuar kritere vlerësimi për një sërë veprimtarish. Një rubrikë përcakton me shkrim atë që një fëmijë duhet të dijë dhe të kuptojë. Rubrikat ndihmojnë mësuesit të përcaktojnë e t'u shpjegojnë fëmijëve dhe prindërve ecurinë e tyre.
Shkallëzimi i të nxënit	Shkallëzimi përdoret për të mbushur boshllëqet e të kuptuarit të fëmijëve duke mësuar konceptet në mënyrë graduale nga forma më e thjeshtë të konceptet e ndërlikuara. Shkallëzimi është një qasje që çon përpara të nxënit e fëmijëve drejt një të kuptuari më të shëndoshë, përfitimi aftësish dhe pavarësi të të nxënit. Si shkallëzimi, ashtu edhe mësimdhënia e diferencuar i ndihmojnë fëmijët të përmirësohen.
Vetëvlerësim	Një vlerësim që i nxit fëmijët të kontrollojnë punën e tyre. Mundësitë për vetëvlerësim ndodhin gjatë punës në grup ose gjatë ndërveprimeve një me një.
Vlerësimi përmbledhës (Vlerësim i të nxënit)	Një vlerësim që përdoret për të raportuar ecurinë e fëmijës gjatë gjithë vitit dhe përfshin interpretimin e të dhënave të mbledhura gjatë një periudhe të caktuar për të njoftuar prindërit.



Referenca

- Copple, Carol dhe Bredekamp, Sue(eds). *Developmentally Appropriate Practice in Early Childhood Programs, Serving Children from Birth Through Age 8*. Botimi i 3-të. Uashington, D.C.: National Association for the Education of Young Children. 2009.
- European Commission. *Proposal for key principles of a Quality Framework for Early Childhood Education and Care. Report of the Working Group on Early Childhood Education and Care under the auspices of the European Commission*. Bashkimi Evropian. 2014.
- Fromberg, Doris. *Play and Meaning in Early Childhood Education*. Boston, M. A.: Allyn and Bacon. 2002.
- Gullo, Dominic F. *Kindergarten Today: Teaching and Learning in the Kindergarten Years*. Uashington, D.C.: National Association for the Education of Young Children. 2006.
- Jablon, Judy R., Dombro, Amy L. dhe Dichtelmiller, Margo L. *The Power of Observation for Birth Through Eight*. Uashington, D.C.: National Association for the Education of Young Children. 2007.
- McCain, Margaret N., dhe Mustard, J. Fraser. *Early Years Study: Reversing the Real Brain Drain*. 1999.
- Shore, Rima. *Rethinking the Brain*. Nju Jork: Families and Work Institute, 1997.
- Vaclavik, Marion, Wolanski, Aimee, dhe Wannamaker, Nancy. *Observation: A Focus on Evaluation, Planning and Growth for the Kindergarten Learner*. Toronto, ON: Elementary Teachers' Federation of Ontario. 2001.
- Vygotsky, L.S. *Mind in Society*, MA: Harvard University Press, 1987.

